

# EKSMAL - 4

*Suva e gatshme vetë-shpërndarëse e cila e kompenson tkurrjen.  
I dedikuar për mbushje të prerjeve me trashësi mbi 20 mm.  
Përgjigjet në EN 1504-3 Klasi R4*

## Fusha e aplikimit:



Eksmal-4 përdoret për sanime konstruktivi të elementeve të betonit dhe betonit me armaturë, për mbushje të vrimave ankoruese, për mbushje të bartësve, trarëve të vija, kushineta makine dhe ngjashëm.

## Cilësi:

- material një-komponentëshe në formë pluhuri;
- lehtë vendoset, vetë-shpërndarës;
- fortësi të larta fillestare dhe përfundimtare;
- e kompenson tkurrjen gjatë lidhjes;
- adezion i shkëlqyer në nënshtresë betoni;
- performansa të shkëlqyera nga aspekti i jetëgjatësisë;
- modul i lartë i elasticitetit;
- rezistent në ndikesa atmosferike;

## Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e fituar me teste fillestare të tipit	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Materie e përhitur pluhur	Materie e përhitur pluhur
Madhësi maksimale e mbushësit	-	4 mm	4 mm
Faktor i ujit dhe materialit	-	0,11	0,11 ÷ 0,13
Vlerë e shpërndarjes (Flow value)	EN 13395-2		≥ 35 cm
-pas 5 min.		≥ 43,0 cm	
-pas 15 min.		≥ 45,0 cm	
-pas 30 min.		≥ 46,5 cm	
-pas 60 min.		≥ 41,0 cm	
Masa e volumit	EN 12190	2380 kg/m <sup>3</sup>	(2350 ± 100) kg/m <sup>3</sup>
Koha e fortësimin	EN 13294		
-fillimi		03h 04min	(2 ÷ 4) h
-fundi		04h 08min	(3 ÷ 5) h
Fortësi në shtypje	EN 12190		
- pas një ditë		36,4 MPa	≥ 30 MPa
- pas 28 ditë		63,6 MPa	≥ 45 MPa
Lidhje adezive pas 28 ditë	EN 1542	3,4 MPa	≥ 2,0 MPa
Adezion pas testit të bërë	EN 13687-1	3,5 MPa	≥ 2,0 MPa
Kompatibilitet termik, Pjesa 1 adezion pas 50 cikleve ngrire/shkrirje	EN 12617-4	3,4 MPa	≥ 2,0 MPa
Rezistencë në karbonatizim	EN 13295	d <sub>k</sub> = 0, отпорен	d <sub>k</sub> ≤ контролен бетон
Modul i elasticitetit	EN 13412	31,1 GPa	≥ 20 GPa
Absorbim kapilar	EN 13057	0,059 kg·m <sup>-2</sup> ·h <sup>-0.5</sup>	≤ 0,5 kg·m <sup>-2</sup> ·h <sup>-0.5</sup>



## METODOLOGJI E REALIZIMIT:

### Përgatitje e nënshtresës:

Nënshtresa në të cilën vendoset Eksmal – 4 duhet të jetë e shëndoshë, e pastër, të mënjanohej të gjitha pjesët labile, pa pluhur, pa yndyrëra dhe e ngopur me ujë. Temperatura e sipërfaqes në të cilën vendoset materiali duhet të jetë në kufijtë prej 5°C deri 30°C.

Gjatë sanimit të elemente të vjetra të betonit me armaturë, armatura që duket dhe ankerët duhet të pastrohet nga korrozioni, mbetje të ngjyrave dhe vajit (me furçë çeliku ose me fërkim me rërë).

### Vendosje:

Eksmal-4 përzihet me sasinë e ujit, e cila për një thes prej 25 kg është prej 2,8 deri 3,4 kg. Përzihet me mikser të ngadalshëm (~ 500 rrotullime në minutë) deri në homogjenizimin e plotë – më së paku 3 minuta.

Përzierja lihet të rri deri 2 – 3 minuta, ndërsa mandej përzihet përsëri dhe vendoset me mbushje në hapje paraprakisht të përgatitura në nënshtresën ose mbulesën. Disa orët e para materiali i vendosur mbrohet nga temperaturat e larta (mbi 30°C) nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell dhe shkujë dhe "kultivohet" me lagje me ujë ose në mënyrë tjetër përkatëse për kultivimin e betonit.

Rekomandohet që Eksmal-4 të përdoret për mbushje të elementeve me trashësi të prerjes prej 2.0 deri 4.0 cm. Shkaku për rekomandimin e tillë është zvogëlimi i efekteve negative nga proceset egzoterme gjatë betonimit të prerjeve më të mëdha. Për prerje më të vogla është e dëshirueshme që të përdoret Eksmal-1, ndërsa për prerje më të mëdha rekomandohet përdorimi i Eksmal-4 me shtimin e fraksioneve agregat të përdorshme për prodhimin e betonit. Proporcionet e përzierjes së Eksmal-4 me fraksionet agregat janë dhënë në tabelat vijuese:

Trashësi e rekomanduar e prerjes	Eksmal-4	Agregat 4-8 mm	Agregat 8-16 mm	Agregat 16-32 mm	Ujë
20 mm+80 mm	25 kg	8 kg	/	/	3.0+3.6 kg
80 mm+160 mm	25 kg	2,5 kg	10 kg	/	3.0+3,7 kg
> 160 mm	25 kg	3,0 kg	5 kg	6,5 kg	2,6+3,4 kg

Gjatë mbushjes së sipërfaqeve më të mëdha me trashësi të vogël, rekomandohet që të vendoset rrjet armaturë çeliku për konstruksione, e lidhur me nënshtresën me anker (min 4/m<sup>2</sup>). Në të kundërtën sipërfaqja duhet të ndahet në katrorë me punimin e fugave punuese menjëherë pas fortësimit të materialit. Në mënyrë shtesë, fugat mund të mbushen me stuko në bazë epokside (i cili mundëson bërjen e sipërfaqes monolite) ose me struko me elasticitet të përhershëm të cilat mundësojnë dilatatim të papenguar gjatë eksploatimit.

Në rastet kur Eksmal-4 vendoset në sipërfaqe më të madhe, me rëndësi të veçantë është të bëhet kujdes për kultivimin e mirë të materialit të vendosur.

### Shpenzimi:

Për 1 m<sup>2</sup> EKSMAL-4 të vendosur nevojitet prej 2100 deri 2300 kg material.

### Pastrimi:

Veglat dhe pajisja pastrohet menjëherë pas përdorimit.

### Paketimi:

Në ventil thasë prej 25 kg.

### Vendosja në depo:

Në ambalazh të mbyllur origjinal. Në hapësira të thata, në temperaturë prej 5°C deri 35°C.

Afati i përdorimit 12 muaj.

## CE shenjë:

 <b>2032</b>	
<b>ADING ShA SHKUP</b> Novosellski pat (rr. 1409) nr. 11,1060 Shkup,R. e Maqedonisë	
<b>11</b> <b>2032-CPD-11.5</b>	
<b>EN 1504-3</b> <b>EKSMAL – 4</b> Prodhim për riparime konstruktuese të betonit CC suva (në bazë të çimentos hidraulike)	
Fortësi në presion:	<b>Klasi R4</b>
Përmbajtje e klor joneve:	<b>≤ 0,05 %</b>
Fortësi adezive (lidhje):	<b>≥ 2,0 MPa</b>
Rezistencë në karbonatizim:	<b>Rezistent</b>
Modul i elasticitetit:	<b>≥ 20 GPa</b>
Kompatibilitet termik, pjesa 1:	<b>≥ 2,0 MPa</b>
Absorbim kapilar:	<b>≤ 0,5 kg·m<sup>-2</sup>·h<sup>-0.5</sup></b>
Reagim në zjarr:	<b>Euroklasi F</b>

**Rrezik për jetën:** Nevojitet që të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë, si dhe thithje e drejtpërdrejtë e komponentit në formë pluhuri. Në rast të kontaktit incidental të prodhimit me lëkurën menjëherë duhet të mënjanohet me ujë dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore.

**Zjarr:** Adingfleks-4 nuk mund të ndizet.

**Pastrimi dhe vendosja në depo:** Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për atë lloj të mbetjeve. Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.